



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVES
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA

Nr / Br. 72/24 Nr. faq / Br.str 03
Data / Datum. 19.11.2024
PRISHTINE / PRISTINA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (11/02 maj 2013), nenit 33 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës (11.06.2024), Vendimit nr. 71/24 të Këshillit Drejtues të Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK), në mbledhjen e mbajtur më dt. 18.11.2024, në të cilën miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PAGESËN E HONORAREVE TË AUTORËVE DHE TË PUNËVE TË TJERA ME HONORAR PËR VEPRIMTARINË BOTUESE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën dhe kushtet e pagesës së honorareve të autorëve dhe punëve të tjera të autorëve për Veprimtarinë botuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës (tani e tutje IPK).

Neni 2 Pagesa për punën në revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike”

Pagesa e punëve për revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike” bëhet për tabak autori (T/A)

1. Kryeredaktori ----- 20 euro
2. Anëtarët e redaksisë..... 15 euro
3. Përgatitja teknike (faqosje) 10 euro
4. Redaktuara gjuhësore për të angazhuar- 10 euro
5. Korrektura (Lektura)10 euro

Neni 3
Pagesa e anëtareve të Këshillit Botues

1. Anëtarët e Këshillit botues paguhen në shumën 100 për një publikim

Neni 4
Pagesa e punëve për botime të veçanta me mbi normë

1. Për botimin e parë të punimit që botohet nga Instituti, honorari paguhet për tabak autori, ku 1 tabak autori i ka 16 faqe tekst A4 (tani e tutje T/A) si vijon:

1.1 Kryeredaktori.....	20 euro
1.2 Redaktori shkencor.....	15euro
1.3 Përgatitja teknike (faqosje)	10 euro
1.4 Redaktuara gjuhësore	10 euro
1.5 Korrektura (Lektura)	10 euro

Neni 5
Pagesa për recensionët e punimeve për botim në revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike”, botime monografi dhe për botime jo monografi

1. Dorëshkrimet për botim në revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike” i nënshtrohen vlerësimit profesional nga dy recensentë.
 - 1.1. Honorari i një recensenti paguhet për numrin e dorëshkrimeve të vlerësuara, 50 euro për një dorëshkrim.
2. Dorëshkrimet për botime monografi i nënshtrohen vlerësimit profesional nga tre recensentë.
 - 2.1. Honorari i një recensenti paguhet për tabak autori, 15 euro për tabak (TA).
3. Dorëshkrimet për botime jo monografi i nënshtrohen vlerësimit profesional nga tre recensentë.
 - 3.1 Honorari i një recensenti paguhet për tabak autori, 10 euro për tabak (TA).

Neni 6
Pagesa e autorit për botim mbi normë (T/A)

1.1 Honorari i autorit për punimin shkencor	100 euro (T/A)
1.2 Honorari i autorit për monografi.....	100 euro(T/A)
1.3 Honorari i autorit për punim jo monografi.....	80 euro (T/A)

Neni 7

Pagesa për organizim të konferencave dhe të aktiviteteve tjera shkencore

- 1.1 Anëtarët e Këshillit organizues të konferencave apo të aktiviteteve tjera shkencore.....100euro
- 1.2 Anëtarët e Këshillit editorial të konferencave apo të aktiviteteve tjera shkencore.....150 euro

Neni 8

1. Angazhimi në projekte shkencore:

- 1.1. Hulumtuesit/punëtorët shkencorë të brendshëm, të angazhuar në projekte shkencore brenda territorit të Republikës së Kosovës me vetura private do të kompensohen në bazë të kilometrave dhe me çmim të kontratave publike për furnizim me derivate.
- 1.2. Hulumtuesve-punëtorëve shkencorë të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në projekte shkencore brenda e jashtë territorit të Republikës së Kosovës u paguhen shpenzimet e akomodimit e të hulumtimit si dhe mëditjet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 9

1. Për të gjitha honoraret që paguhen sipas kësaj rregullore është e obligueshme pagesa e tatimit në burim sipas shkallës që zbatohet në Kosovë.

Neni 10

II. Dispozitat përfundimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues të Institutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja për veprimtarinë botuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Nr. 54/24 të datës 12.09.2024.
3. Plotësimet dhe ndryshimet e kësaj rregullore bëhen me procedurë të njëjtë, e cila vlen për miratimin e saj.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Dr. Sc. Osman Buleshkaj

